

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË AMENDAMENTIN E KIGALIT, TË PROTOKOLLIT TË MONTREALIT, “PËR SUBSTANCAT QË HOLLOJNË SHTRESËN E OZONIT””

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Amendamenti i Kigalit, i Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”, ka për qëllim vijimin e qasjes dhe zotimit ndërkombëtar për të frenuar ndryshimet klimatike. Ky amendament është miratuar më 15 tetor të 2016, në Ruandë, dhe do të hyjë në fuqi më 1 janar 2019, mbas ratifikimit nga, të paktën, 20 shtete palë të protokollit të Montrealit.

Amendamenti i Kigalit sanksionon detyrimin për të reduktuar përdorimin e gazeve të fluorinuara, siç janë hidrofluorokarbonet (HFC), kimikate me prejardhje antropogjenike dhe potencial të lartë ndikimi në ngrohjen globale. HFC-të janë gaze me efekt serrë dhe kanë potencial të ngrohjes globale shumë herë më të lartë se dioksidi i karbonit. HFC-të, në vetvete, nuk janë gaze ozonholluese dhe që përdoren si alternativa të tyre, por kanë potencial të lartë në ngrohjen globale. Sipas tekstit përfundimtar të amendamentit u krijuan tri grupe shtetesh në lidhje me përcaktimet sasiore dhe kohore të reduktimit të HFC-së. Aneksi F, i amendamentit të Kigalit i liston HFC-të dhe i ndan ato në dy grupe: Grupi I dhe Grupi II. Bazuar në këtë amendament, palët në Protokollin e Montrealit duhet të reduktojnë, gradualisht, përdorimin e HFC-ve me 80 - 85 % deri në vitin 2040. Vendet e zhvilluara e fillojnë kufizimin e HFC-ve në vitin 2019. Disa nga vendet në zhvillim e fillojnë këtë proces në vitin 2024 dhe të tjerat në vitin 2028.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është pjesë përbërëse e programit analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2018, por është në përputhje me programin politik të qeverisë dhe programin e përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për nismat ligjore e nënligjore që duhen ndërmarrë për përmirësimin e kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator për mjedisin, të cilat kanë si qëllim të promovojnë ndërmarrjen e veprimeve më të forta ndaj ndryshimeve klimatike,

duke iu bashkuar vendeve pale të Protokollit të Montrealit, për shmangien deri në 0.5°C të ngrohjes globale deri në fund të shekullit, ndërkohë që vazhdon të mbrohet shtresa e ozonit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nevoja e hartimit të këtij projektligji vjen:

Së pari nga domosdoshmëria që Republika e Shqipërisë, si pjesë e komunitetit të Protokollit të Montrealit, duhet të përputhë kuadrin e saj ligjor me atë të Bashkimit Evropian dhe vendeve të tjera të globit, sipas përcaktimeve të amendamenteve të Protokollit të Montrealit për lëndët ozonholluese. Protokolli i Montrealit është ratifikuar nga vendi ynë me ligjin nr.8463, datë 3.10.1999, sikurse janë ratifikuar të gjitha amendamentet e Protokollit të Montrealit, me përjashtim të Amendamentit të Kigalit, në të cilin po aderojmë.

Protokolli i Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit” është traktati i parë, i cili është ratifikuar nga 197 shtete, cilësohet si ngjarja më e rëndësishme në diplomacinë moderne dhe ka shënuar arritjen parësore të uljes me 99% të sasisë së lëndëve ozonholluese nga data e hyrjes në fuqi dhe deri më sot, duke zvogëluar dëmtimet dhe hollimin e shtesës së ozonit. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje është krijuar edhe korniza e bashkëpunimit ndërkombëtar për mbrojtjen e shtesës së ozonit.

Së dyti, nëpërmjet Amendamentit të Kigalit, komuniteti i Protokollit të Montrealit, pjesë e të cilit është edhe Shqipëria, merr përsipër përgjegjësinë për HFC-të që kontribuojnë në qëllimet e qëndrueshmërisë, në përputhje me agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj hartohet në bazë të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, si dhe është në përputhje me nenin 18, të ligjit nr.43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe nenin 35, të ligjit nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar.

Nëpërmjet miratimit të këtij amendamenti realizohet respektimi i detyrimeve që i takojnë Republikës së Shqipërisë, si palë në Protokollin e Montrealit të vitit 1987 “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”. Si rrjedhojë e detyrimeve që lindin nga këto marrëveshje është realizuar edhe përafrimi dhe ndryshimet ligjore përkatëse në legjislacionin e brendshëm.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Më 17 korrik 2017, Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi vendimin për të përfunduar procesin e ratifikimit, në emër të BE-së, të Amendamentit të Kigalit, të Protokollit të Montrealit, i cili do të sigurojë mbrojtjen e klimës nga hidrofluorokarbonet (HFC). Ndërkohë që shtetet palë të Bashkimit Evropian, në cilësinë e subjekteve të së drejtës ndërkombëtare, kanë ratifikuar këtë amendament ose janë në fazën e ratifikimit të tij.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nëpërmjet Amendamentit të Kigalit, komuniteti i Protokollit të Montrealit, pjesë e të cilit është edhe Shqipëria, merr përsipër përgjegjësinë për HFC-të, duke kontribuar në qëllimet e qëndrueshmërisë, në përputhje me agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm. Me hyrjen në fuqi të Amendamentit të Kigalit, sipas përcaktimeve të nenit 4, të këtij Amendamenti, kufizohet tregtia e HFC-ve ndërmjet shteteve palë dhe jopalëve, duke paragjykuar pozitat e shteteve jo palë. Amendamenti nuk eliminon tërësisht HFC-të, por parashikon kontrollin e substancave të listuara për shkak të ndikimit të tyre në atmosferë.

Miratimi i teknologjive të reja do t'u mundësojë vendeve palë të fitojnë avantazh konkurrues në treg, pasi shumë prej teknologjive alternative të zhvilluara së fundi kanë si efekt direkt rritjen e efikasitetit të energjisë dhe në përmirësimin e cilësisë së produkteve.

Sipas nenit 5, të Amendamentit të Kigalit, shtetet palët do të jenë subjekte të ndihmës financiare, nëpërmjet mekanizmit të fondit shumëpalësh për realizimin dhe përbushjen e detyrimeve të tyre.

Zbatimi i këtij amendamenti pritet të parandalojë ngrohjen deri në 0.5 ° celcius deri në fund të shekullit, duke dhënë, kështu, një kontribut pozitiv në arritjen e objektivave të Marrëveshjes së Parisit.

Ky amendament sanksionon përdorimin në mënyrë efektive të substancave me potencial të ulët ose zero të ngrohjes globale si dhe përdorimin e substancave që nuk dëmtojnë shtresën e ozonit. Megjithatë Protokollin e Kiotos (Shqipëria është pjesë e Protokollit të Kiotos) kontrollon tashmë shkarkimet e disa alternativave të substancave ozonholluese, që kanë potencial të lartë të ngrohjes globale, ndryshimet e propozuara në Protokollin e Montrealit synojnë kontrollin e prodhimit dhe të konsumit të këtyre substancave.

Miratimi i amendamentit për hidrofluorokarbonet do të japë përfitime të konsiderueshme në dekadat e ardhshme dhe do të ndihmojë në avancimin e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Protokolli i Montrealit njohu në mënyrë zyrtare detyrimin për marrjen e masave të menjëhershme për të kufizuar dhe ndaluar hollimin e shtresës së ozonit. Ky kufizim do të mundësohej nëpërmjet reduktimit deri në ndalim të prodhimit e konsumit të lëndëve që ndikojnë në hollimin e shtresës së ozonit. Protokolli i Montrealit është marrëveshja më e suksesshme mjedisore shumëpalëshe.

Masat që ajo ka gjeneruar kanë bërë që:

- shtresa e ozonit dhe hollimet e saj kanë filluar të rikuperohen;
- vrima e ozonit në Antarktik pritet të zhduket deri në vitin 2050;
- të eliminohet prodhimi dhe konsumi i substancave ozonholluese

Protokolli është i rëndësishëm edhe në luftën kundër ndryshimeve klimatike, duke reduktuar emetimet e gazeve me efekt serra më shumë se 135 miliardë tonë CO₂.

Protokolli i Montrealit është një marrëveshje ndërkombëtare, e firmosur në 16 shtator 1987, me objektivin për të mbrojtur shtesën e ozonit nëpërmjet instrumentit të eliminimit gradual të konsumit dhe prodhimit të lëndëve ozonholluese. Miratimi i këtij Protokolli ishte në vijim të miratimit të Konventës së Vjenës për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit, e firmosur më 22 mars 1985. Duke njohur dhe ruajtur pacenueshmërinë e së drejtës sovrane të secilit shtet për të shfrytëzuar burimet e tyre të brendshme, në përputhje me politikat respektive mjedisore, kjo Konventë nënvizoi përgjegjësinë individuale dhe kolektive, për të garantuar që aktiviteti i ushtruar brenda secilit juridiksion dhe kontroll të mos dëmtojë mjedisin e shteteve të tjera, si dhe nënvizoi urgjencën për të ndërmarrë masa mbrojtëse për dëmtimet e shtresës së ozonit, të cilat janë rrjedhojë e aktiviteteve njerëzore dhe kërkoi një bashkëpunim ndërkombëtar, bazuar në konsiderata teknike dhe shkencore.

Në mungesë të kësaj marrëveshjeje për mbrojtjen e mjedisit dhe parashikimeve të saj, shtresa e ozonit në stratosferë nuk do të kishte përmbushur funksionin e saj thelbësor, mbrojtjen e tokës nga rrezet e dëmshme UV, dhe si rrjedhojë do të përkthehej në një rritje të sasisë së këtyre rrezeve, rrezatim i cili do të kishte efekte direkte në sistemin imunitar si dhe dëmtime të pyjeve, agrikulturës dhe ujërave.

Protokolli i Montrealit është përkufizuar nga z. Kofi Anan, ish-Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, si marrëveshja ndërkombëtare më e suksesshme e realizuar deri më sot.

Protokolli i Montrealit është amenduar 5 herë, duke forcuar masat kontrolluese si dhe duke:

- a) përcaktuar një kalendar për eliminimin gradual të prodhimit dhe konsumit të lëndëve ozonholluese;

- b) vlerësuar dhe rishikuar masat e kontrollit, bazuar në informacionin aktual shkencor, mjedisor, teknik dhe ekonomik.

Protokolli i Montrealit, në kuadër të parimit “përgjegjësi e përbashkët por e diferencuar” ndan dhe klasifikon shtetet palë në dy kategori, duke përcaktuar edhe kalendarë të ndryshëm për secilën kategori në lidhje me eliminimin e lëndëve ozonholluese:

- a) Vendet në zhvillim (të cilat veprojnë sipas përcaktimeve të nenit 5 të Protokollit të Montrealit);
b) Vendet e zhvilluara (të cilat veprojnë konform përcaktimeve të nenit 2 të Protokollit të Montrealit).

Për të asistuar financiarisht vendet në zhvillim, në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Protokollin e Montrealit, është ngritur dhe funksionon edhe fondi shumëpalësh (MF) i financimeve.

Protokolli i Montrealit për lëndët ozonholluese është ratifikuar nga vendi ynë me ligjin nr.8463, datë 3.10.1999. Si rrjedhojë e detyrimeve që lindin nga këto marrëveshje është realizuar edhe përafrimi dhe ndyshimet ligjore përkatëse në legjislacionin e brendshëm.

Amendimet e Protokollit të Montrealit:

- Amendamenti i Londrës (1990) aderuar;
- Amendamenti i Kopenhagenit (1992) aderuar;
- Amendamenti i Montrealit (1997) aderuar;
- Amendamenti i Pekinit (1999) aderuar;
- Amendamenti i Kigalit (2016) i paaderuar.

Shqipëria ka aderuar të gjitha amendamentet e protokollit të Montrealit me përjashtim të Amendamentit të Kigalit.

Amendamentet e Protokollit të Montrealit janë aderuar nga Republika e Shqipërisë me ligjet e listuara si më poshtë:

- Amendamenti i Londrës, i Protokollit të Montrealit - me ligjin nr.9484 datë 2.3.2006 (27-29 qershor 1990);
- Amendamenti i Kopenhagenit, i Protokollit të Montrealit - me ligjin nr.9480, datë 16.2.2006 (23-25 nëntor 1992, Kopenhagen)
- Amendamenti i Montrealit, i Protokollit të Montrealit - me ligjin nr.9485, datë 6.3.2006 (15-17 shtator 1997, Montreal);
- Amendamenti i Pekinit, i Protokollit të Montrealit - me ligjin nr.9486, datë 6.3.2006 (29 nëntor – 3 dhjetor 1999, Pekin);

Mbështetur në kuadrin ekzistues, përveç rasteve kur në mënyrë të shprehur parashikohet ndryshe, ndalohet:

- prodhimi i substancave ozonholluese, produkteve dhe përzierjeve që përmbajnë substanca të listuara në anekset A, B, C dhe E, të Protokollit të Montrealit;
- importi, marketingu, eksporti dhe kalimi tranzit i produkteve që përmbajnë përzierje të substancave ozonholluese dhe pajisjet që përdorin substancat e listuara në anekset A, B, C dhe E të Protokollit të Montrealit;
- çlirimi në ajër i substancave ozonholluese të renditura në anekset A, B, C dhe E të Protokollit të Montrealit;
- përdorimi i substancave ozonholluese dhe produkteve që përmbajnë këto substanca, të cilat përdoren në bujqësi për qëllime specifike;
- eksporti i substancave ozonholluese, i produkteve që i përmbajnë ato dhe pajisjet e përdorura, në një vend që nuk është palë në Protokollin e Montrealit;
- importi i substancave ozonholluese të ricikluara ose të rikuperuara;
- importi i substancave ozonholluese të përfshira në shtojcën C, grupi I, lejohet vetëm në bazë të kuotave vjetore të përcaktuara dhe të miratuara për Shqipërinë;
- importi i substancave ozonholluese, produktet e gomave, pajisjet që përmbajnë substanca të tilla, nga një vend që nuk është palë në Protokollin e Montrealit;
- përdorimi i substancave ozonholluese dhe produkte që përmbajnë këto substanca, të cilat përdoren në bujqësi për qëllime specifike;
- eksporti i substancave ozonholluese dhe produktet që përmbajnë ato dhe pajisjet e përdorura, në një vend që nuk është palë në Protokollin e Montrealit;

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e projektligjit janë ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Njësinë Kombëtare të Ozonit (NOPIU).

Projektligji është bashkërenduar me Ministrinë për Evropën dhe Punë e Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të cilat janë shprehur dakord me nismën propozuese.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektakt nuk parashikon të ketë impakt në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE